

| 2023 - 2024 |

BULETIN

REVISTË VJETORE



KONKURSE-AKTIVITETE-KËSHILLIM

Turgut Ozal High School Tirana

**REDAKTORE
RAJMONDA HAXHIAJ**

**FOTOGRAFE / DESIGNER
OLA XHAFERAJ**

**Adresa: Rr.Pavarësia
Autostrada Tiranë-Durrës km2,
Kashar, Tiranë
Tel: +355693183041**

KOL

EDITORIAL

Edukimi është pasaporta për të ardhmen, por, e nesërmja, iu përket atyre, të cilët e përgatisin atë sot.

Prandaj, ne i përgatisim nxënësit tanë në menyrë të tillë, që, cilido të jetë i sigurtë.

Shkolla jonë është pjesë e një sistemi arsimimi të ngjashëm me atë të standarteve europiane.

Suksesi i shkollës sonë qëndron në programet tepër të përparuara të lëndëve shkencore, si dhe ndërthurjen e procesit mësimor me aktivitete të shumta sociale, të cilat e gjallërojnë dhe pasurojnë jetën e një gjimnazisti.

Përkushtimi i nxënësve dhe puna e palodhur e mësuesve, janë ato elemente që i japin mësimdhënies dhe mësimnxënies, një frymë të re, duke zgjuar e motivuar të nxënësit talentin e dhuntitë.

Një nga përparësitë e shkollës sonë janë konkurset e olimpiadat kombëtare e ndërkombëtare, të cilat nxisin imagjinatën e nxënësve, duke i bërë ata të sfidojnë veten e tyre, në fusha të ndryshme të jetës.

Duke besuar se e ardhmja rritet çdo ditë hap pas hapi, përmes një edukimi sa më të mire të vlerave njerëzore e shoqërore, ne realizojmë detyrën tonë në emër të zhvillimit e emancipimit.



PËRMBAJTJA

1. TË FTUAR

Takim me shkrimtarin e madh, Ismail Kadare.....	8
Takim me gazetarin e njohur, Erion Kristo.....	8
Takim me gazetarin, Roland Qafoku.....	9
Takim me historianin, Irakli Koçollari.....	9
Takim me arkeologun, Z.Neritan Ceka.....	10
Takim me Gazetarin Lorenc Vangjeli.....	10
Takim me Z.Fatmir Gjoni.....	11
Takim me presidenten e organizatës “Europa Donna Albania”, Donjeta Zeqa.....	11
Takim me Andi Lilën dhe Alban Bushin.....	11
Z. Paskal Milo, ish-ministër i Jashtëm, viziton shkollën tonë.....	12
Seminar me temë: "Motivim drejt Sipërmarrjes dhe Inovacionit", nga Z. Gerti Boshnjaku.....	12
Takim me gazetarin e famshëm, Z. Marin Mema.....	13
Bisedë me Z.Blendi Fevziu në mjediset e shkollës së mesme jopublike "Turgut Ozal".....	13
Klodiana Lala në Turgut Ozal.....	14
Takim me Z. Besnik Karaj.....	14
Bashkëbisedim me avokaten, Znj.Rudina Jasini.....	14
Takim me aktorin Gentian Zenelaj.....	15
Bisedë me shkrimtaren dhe autoren e teksteve, Rita Petro.....	15
Seminar me Z. Qemal Zaimi.....	15

2. MUAJI I ARTIT DHE LETËRSISË

Takim frymëzues me botuesen, Znj. Arlinda Duda.....	17
Takim frymëzues me autoren Monika Stafa dhe drejtoreshën e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli.....	17
Seminar me gazetaren, Znj. Alma Çupi.....	18
Takim me drejtueset e shtëpisë botuese “Muza”, Klodiana Metani dhe Irma Dudushi.....	18
Aktivitet në kuadër të Muajit të Artit dhe të Letërsisë.....	19
Takim me gazetarin Enrik Mehmeti.....	19
Takim me violinistin Olen Cesari.....	20
Udhëtim nëpër botë.....	21

3. JAVËT E SHKENCAVE

Njohja me funksionimin dhe ndërtimin e mëlçisë.....	24
Fakulteti i Mjekësisë pret nxënësit e shkollës “Turgut Ozal”.....	24
Nxënësit e Klubit të Mjekësisë vizituan Klinikën Keit.....	24
Nxënësit e Klubit të Mjekësisë vizituan ambientet e CFO-së.....	25



Pranë ambienteve të Klinikës Gjermane të Syrit	25
Vizitë në Your Medical Clinic	25
Vizitë në Spitalin Amerikan 2.	26
Njohja me fushën e kardiologjisë - Vizitë në Spitalin Amerikan 3.....	26
Bisedë me Dr. Eldores Sula	26
Seminar me mjeken Migena Vargu	27
Bisedë me Gledis Nanon dhe Dr. Gentjan Skara	27
Bisedë me Dr. Nertil Mera	27
Vizitë në Cambridge Clinical Laboratories.....	28
Bisede rreth degës së arkitekturës, drejtuar nga Rudina Belba.....	28
Bisedë me Dr. Irma Gjana.....	28
Vizitë në Klinikën Art Orl Clinic	29
Vizitë në Spitalin e Traumës, në Tiranë	29

4. JAVËT E SHKENCAVE SOCIALE

Takim me arkeologun e njohur, Z. Jani Koçillarin	31
Awarenes Club, një zë frymëzues	31
"Të fuqizuar nga dijet, të bashkuar kundër bullizmit."	31
Pranë ambienteve të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë.....	32
Bashkëbisedim me prof. Niuton Mulleti.....	32
Seminar për Ditën e Tokës	33
Seminar nga Prof. Asoc. Majlinda Keta.....	33
Kujdesi për shëndetin mendor është jetik	33
Takim me historianin e njohur, Z. Pëllumb Xhufi	34
Social Sciences Week - Java e Shkencave Sociale	34
Aktivitet i zhvilluar nga Prof. As. i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Z. Mihallaq Qirjo.	35
Vizitë në Institutin e Fëmijëve që nuk dëgjojnë.....	35
Bisede me Z. Aljaz Kuncic, Economics for Development në UN Albania	36
Bashkëbisedim në Ditën e Familjes.....	36
Ndërgjegjësohemi për shëndetin mendor.....	36

5. OLIMPIADA, PROJEKTE DHE KONKURSE

Konkursi i Letërsisë: Të mësuarit përmes garës	38
Finalja e Tavolinës së Debatit	38
Konkursi i Projekteve 3D.....	38
Momente krenarie për gjimnazin “Turgut Ozal”!.....	39
Fituesit e universiteteve më të mira vizitë te “Rudina”.....	39
Konkursi i Historisë mes klasave të 11-ta.....	40



PËRMBAJTJA

Konkursi i Fizikës	40
Nxënësi Nio Mullanji bëhet pjesë e aktivitetit LevelUP.....	40
FIRST LEGO LEAGUE	41
Olimpiada Ndërkombëtare Purple Math Comet	41
Konkursi Trivia gjatë Javës së Shkencave	42
Kampionati i Shahut	42
International Genius Olympiads	42
Fundjava e pabesueshme e ASEF-it.....	43
Fitues në Olimpiadën Ballkanike të Fizikës	43
Triumfues në Olimpiadën Ballkanike të Shkencave.....	43
Të bëjmë një ndryshim së bashku!.....	44

6. KËSHILLIM DHE KARRIERË

Rezultatet dhe destinacionet 2023-2025	47
Rezultatet dhe destinacionet 2023-2025	48
Takim me Z. Craig Wilson, CEO I CATS Global Schools	49
Seminar me përfaqësues të Northwest University	49
Takim me profesorë të Kolegjit Universitar Beder.....	50
Shkolla jonë pret për vizitë ekipin e menaxhimit të Universitetit Epoka.	50
Takim me Aida Hudhrin, Këshilltare për Arsimin pranë Ambasadës së SHBA-së në Tiranë	51
Vizitë nga përfaqësuesit e Universitetit Webster	51
Vizitë nga përfaqësues të Universitetit Kembrixh, për procesin e akreditimit	52
Përfaqësues të CATS Cambridge vizitojnë shkollën tonë.....	52
Seminar me Ana Mullanjin, përfaqësuese e Erasmus	53
Bisedë me ish-nxënësin e shkollës sonë, Kristi Bushin.....	53
Java e Karrierës, 2024.....	54

7. KLUBE

Vizitë në Muzeun e Forcave të Armatosura.....	56
Takim me Z. Murat Sahin	56
Seminar me Z. Leons Hasani.....	57
Takim me poetin dhe dramaturgun arbëresh, Mario Caliva.....	57
International Relations and Politics Club mban seminar për nxënësit e klasave të 6-ta.....	57
Takim me Znj. Kamela Hasko	58
Vizitë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	58
Vizitë në Universitetin Epoka	58
Vizitë në “AKH Consulting”	59



Vizitë në ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë	59
Vizitë në Durrës pranë stacionit të trenit në ndërtim!	59
Takim me përfaqësues nga Ambasada Amerikane, Chad Twitty - Public Affairs Officer	60
Vizitë në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit	60
Vizitë pranë Klinikës Dentare ``Vraja``	61
Vizitë në Bashkinë e Tiranës.....	61
Takim me CEO-n e Intesa Sanpaolo Bank.	62
Takim me logopeden, Iva Muskaj.....	62
Trajnimi Skills 4 Change Albania.....	63
Seminar nga AMA.....	63
Seminar nga Sonila Bitri, rreth Drograve dhe Varësive ndaj tyre.....	64
Vizitë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social.....	64
Vizitë unike në ambientet e Spitali Amerikan 3.....	65
Seminar me temë: “ Management of Information Systems”	65

8. EKSURSIONE

Udhëtim në Mynih	67
Maturantët e shkollës sonë zhvilluan një udhëtim magjik në Romë.	67
Nxënësit tanë vizitojnë Hungarinë.....	67
Udhëtim në Mynih	68
Vizitë në qytetin e Korçës	68
Udhëtim në Gjermani.....	69
Udhëtim në Holandë	69
Udhëtim në Barcelonë.....	70
Eksplorimi i jetës universitare në Milano!.....	70
Vizitë në Oslo, Norvegji	71
Udhëtim në Romë	71
Vizitë në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta.....	71
Grupi Top Scorers eksursion në Gjermani.....	72
Udhëtim në Mynih	72
Vizitë në muzeun Bunkart.....	72
Klubi i Arkitekturës viziton Vjenën.....	72
Udhëtim në Zvicër	73
Klubi i Mjekësisë viziton Gjermaninë	73
Vizitë në Universitetin Webster	74
Vizitë në Shpellën e Mermerit	74



TË FTUAR



Takim me shkrimtarin e madh, Ismail Kadare

Ishte një kënaqësi e madhe për shkollën tonë, që një grup nxënësish dhe mësuesish, takuan shkrimtarin shqiptar me famë botërore, Ismail Kadarenë. Nxënësve iu dha mundësia që të diskutonin rreth veprave të tij më të njohura, si dhe të shuanin kuriozitetin e tyre, duke drejtuar pyetje lidhur me procesin e tij krijues. Ndihe mi falenderues që shkrimtari, Ismail Kadare, vendosi të na jepte kohë nga koha e tij e vyer.

Takim me gazetarin e njohur, Erion Kristo

Shkolla jonë pati nderin dhe kënaqësinë që të presë në ambientet e saj gazetarin e njohur dhe intelektualin me vlera e kontribut të lartë shoqëror, Z. Erion Kristo.

Z. Kristo zhvilloi një seminar me nxënësit, me fokus në aftësimin për menaxhimin e kohës, kreativitetin dhe të menduarit kritik.

Nxënësit u larguan nga ky takim më të motivuar dhe më me vullnet për të nxjerrë në pah më të mirën e tyre.



Takim me gazetarin, Roland Qafoku



Një kënaqësi e veçantë për shkollën tonë, mbetet seminari i mbajtur nga gazetari dhe autori i librave historikë, z. Roland Qafoku. I rrethuar nga një grup nxënësish, z. Qafoku diskutoi rreth historisë së Shqipërisë, studimeve që ka realizuar gjatë viteve, profesionit të gazetarit, si dhe librave që mbajnë autorësinë e tij.

Ne i jemi mirënjohës gazetarit të njohur për takimin dhe shpalosjen e njohurive të shumta për Shqipërinë dhe profesionin e tij, përballë nxënësve tanë.

Takim me historianin, Irakli Koçollari



Festat e nëntorit na presin me një sërë aktivitete në shkollën tonë. Një ndër to ishte dhe takimi me historianin, Irakli Koçollari. Gjatë këtij takimi u diskutua rreth historisë së Shqipërisë dhe biseda u fokusua kryesisht në periudhën e pushtimit osman. U fol për Perandorinë e madhe Otomane, për figurat e shquara që i sollën pavarësinë shtetit tonë (si Ismail Qemali), si dhe për marrëdhëniet tona politike me Perëndimin. Nxënësit patën mundësi t'i drejtojnë pyetje historianit, për të shuar kuriozitetin dhe për t'u informuar më tej, për këtë periudhë të rëndësishme të historisë së Shqipërisë.



Takim me arkeologun, Z. Neritan Ceka

Arkeologu më i njohur shqiptar dhe ish-ministri i brendshëm, z. Neritan Ceka u bë pjesë e një takimi tepër të këndshëm, informues e plot me dije të panjohura më parë prej nxënësve tanë. Tema e bashkëbisedimit ishte : "Një udhëtim arkeologjik në Shqipëri".

Apolonia, Amantia, Bylisi, rruga Egnatia, Lini dhe padyshim varret monumentale të Selcës së Poshtme ishin vendet të cilat zgjuan më shumë kuriozitetin dhe tek të cilat u përqendruan pyetjet kryesore të nxënësve.

A janë pellazgët paraardhësit e ilirëve? Nxënësit e morën përgjigjen nga ky bashkëbisedim. Falenderuam z. Ceka me shpresën se do ta kemi sërish midis nesh.



Takim me Gazetarin Lorenc Vangjeli

“Kritika është arti i nevojshëm që mundëson rritjen e karakterit të individit.”

Me dëshirën për të përcjellë këto mësimet universale, si dhe në kuadër të “Muajit të Letërsisë”, në shkollën tonë patëm kënaqësinë e madhe të kishim të ftuar, analistin e njohur dhe gazetarin, Lorenc Vangjeli.

Kritika ndaj ndodhive të së përditshmes është një aftësi shumë e rëndësishme në shekullin XXI, ndaj pikëpamjet e një vëzhguesi të rregullt, “qortuesi” të aktualiteit dhe analisti politik priten me mjaft entuziazëm nga nxënësit. Nëpërmjet rrëfimit të përvojave personale, metaforave të këndshme, si dhe këshillave për jetën, zoti Vangjeli preku tema të cilat janë me mjaft interes. Gjatë gjithë bashkëbisedimit, ai nuk zgjodhi te ulej për asnjë moment duke përcjellë devotshmëri dhe pasion në analizat e mirëfillta që e karakterizojnë. Me anë të krahasimit të mundësive dhe pikëpamjeve të një gjimnazisti sot dhe para disa vitesh, zoti Vangjeli u tregua sa empatik, por aq edhe realist, duke frymëzuar nxënësit për potencialin e pafundëm që ata mbartin.

Këshillat dhe historitë e vyera të zotit Vangjel, lanë mbresa të mëdha te secili prej nesh.





Takim me Z.Fatmir Gjoni

Klubi i Ekonomisë zhvilloi një leksion frytdhënës dhe plot me informacione, me temë: "Bota e biznesit po të pret!" Me angazhimin në këtë seminar, z. Fatmir Gjoni përcolli jo vetëm njohuri, por edhe mesazhe shumë të rëndësishme rreth arritjes së suksesit në biznes.



Takim me presidenten e organizatës “Europa Donna Albania”, Donjeta Zeqa

Në shkollën tonë u zhvillua një takim me presidenten e organizatës “Europa Donna Albania”, Donjeta Zeqa, në kuadër të Muajit Ndërgjegjësues për kancerin e gjirit. Takimi rezultoi të ishte motivues për nxënësit e klubeve, që të jenë pjesë e nismave vullnetare, si mënyrë efektive për të përmirësuar veten dhe shoqërinë.



Takim me Andi Lilën dhe Alban Bushin

Kujtuam në shkollën “Turgut Ozal” tetorin e vitit 2014, kur këta djem të Kombëtares së futbollit, në ndeshjen Serbi-Shqipëri, mbrojtën me dinjitet flamurin shqiptar. Andi Lila dhe Alban Bushi na nderuan, duke marrë pjesë në aktivitetet që po zhvillohen në shkollën tonë, në kuadër të Muajit të Historisë dhe Gjeografisë.



Z. Paskal Milo, ish-ministër i Jashtëm, viziton shkollën tonë



Një takim mbresëlënës u zhvillua në mjediset e shkollës sonë, me historianin dhe ish-ministrin e Jashtëm, z. Paskal Milo.

Z. Milo përgëzoi nxënësit dhe mësuesit për pasionin që ata kanë treguar gjatë Muajit të Historisë, duke e kthyer të gjithë shkollën e mesme "Turgut Ozal" në një arkivë dhe muze me prodhime artizanale shqiptare ndër shekuj; flamuj, postera, dokumente origjinale, stoli, makete kështjellash etj. Emocionuese për të ishin gjithashtu edhe pyetjet që nxënësit i drejtuan, të cilave z. Milo iu përgjigj me shumë kënaqësi.



Seminar me temë: "Motivim drejt Sipërmarrjes dhe Inovacionit", nga Z. Gerti Boshnjaku



Në shkollën tonë u zhvillua një seminar me temë: "Motivim drejt Sipërmarrjes dhe Inovacionit", nga z. Gerti Boshnjaku (Ceo&Co Founder Business MAG).

Nxënësit e disa prej klubeve (Klubi i Ekonomisë, Klubi E-business, Klubi i Programimit dhe Public speaking) shfaqën interes, duke bërë pyetje rreth temës dhe morën një informacion të përgjithshëm rreth startup-ve dhe funksionimit të tyre.

Ky ishte një seminar këshillues, motivues dhe mbështetës për nxënësit tanë.



Takim me gazetarin e famshëm, Z. Marin Mema

Në shkollën tonë u zhvillua një takim me një nga figurat më të ndjekura të gazetarisë hulumtuese, gazetarin e dashur për të gjithë publikun shqiptar, kërkuesin e "Gjurmëve Shqiptare", z. Marin Mema. Gjatë këtij takimi tepër të ngrohtë u diskutuan tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me historinë tonë, por edhe tema aktuale. Marini u ndal tek puna e tij kërkimore në lidhje me Diasporën Shqiptare. Sipas tij, një rëndësi të madhe ka njohja e së vërtetës; ajo është një mundësi e madhe që kombët, sikurse kombi ynë, të ecin para. Nxënësit e shijuan thellësisht këtë diskutim. Ata, ashtu si dhe ne, urojnë që të kenë një mundësi tjetër për të diskutuar dhe folur me z. Marin Mema.



Bisedë me Z. Blendi Fevziu në mjediset e shkollës së mesme jopublike "Turgut Ozal"

Gazetari, shkrimtari dhe moderatori i njohur, Blendi Fevziu vizitoi mjediset e shkollës sonë dhe zhvilloi një bisedë motivuese me gjimnazistët. Vetë prezenca e Blendit, si një nga figurat më të ndjekura të gazetarisë televizive, shtoi më shumë kureshtjen dhe dëshirën për pjesëmarrje. I hapur ndaj çdo pyetjeje, duke sjellë sekuenca kujtimesh, ngjarjesh, përjetimesh, udhëtimesh, kjo bisedë ndikoi ndjeshëm te të gjithë. Me dëshirën për ta pasur përsëri midis nesh, ne e falenderuam zotin Fevziu për kohën që na kushtoi.



Klodiana Lala në Turgut Ozal

Në mjediset e shkollës sonë patëm kënaqësinë të kishim në një bashkëbisedim tepër të këndshëm gazetaren e mirënjohur të gazetarisë investigative, Klodiana Lalën.

Klodiana ndau me nxënësit disa nga momentet më emocionuese të karrierës së saj.

Gazetarja tregoi për vështirësitë që një gazetar mund të hasë në punën e tij, por edhe kënaqësitë që të jep pasioni për të vërtetën. Mesazhet që ajo përcolli, do të jenë motivim e frymëzim për nxënësit tanë për një kohë të gjatë.



Takim me Z. Besnik Karaj

Në mjediset e shkollës sonë u zhvillua një takim me Z. Besnik Karaj, inxhinier mekanik.

Biseda u fokusua në fushën e inxhinierisë mekanike dhe mekatronike.

Inxhinieri ndau me nxënësit përvojat e tij për konstruktin mekanik të përdorur në Stadiumin Air Albania, përvojat për inceneratorët dhe ujësjellësit në Holandë, transportin kompleks në Japoni e Indi.

Kjo seancë u erdhi në ndihmë nxënësve që synojnë degët e inxhinierisë.


I jemi mirënjohës z. Besnik për njohuritë e përvojat që ndau me ne!



Bashkëbisedim me avokaten, Znj. Rudina Jasini

Nxënësit e Klubit International Relations and Politic patën kënaqësinë e madhe të bashkëbisedojnë me avokaten shqiptare, të njohur nëpër botë, Znj. Rudina Jasini.

Gjatë diskutimeve, nxënësit u njohën më shumë me punën e sukseset e zonjës Jasini dhe morën përgjigje për të gjitha pyetjet që ata kishin rreth sistemit të drejtësisë dhe funksionit të tij.



Takim me aktorin Gentian Zenelaj

Me prezencën e tij, aktori Gentian Zenelaj u bë një model frymëzimi për nxënësit tanë, duke i inkurajuar ata të ndjekin pasionet e tyre dhe të jenë të vendosur për të arritur objektivat në jetë. Këtë gjë ai e arriti me mjeshhtëri duke ndarë përvojat dhe historitë e karrierës së tij. Aktori dha një perspektivë të veçantë mbi botën e artit, sfidat e kënaqësitë e një karriere artistike. Ne i jemi falenderues aktorit për mesazhet e vyera dhe energjinë pozitive që përcolli!



Bisedë me shkrimtaren dhe autoren e teksteve, Rita Petro.

Letërsia, shkrimi, botimet e shumë aspekte të tjera që lidhen me fushën e krijimtarisë u bënë qendra e kësaj bisede. Autorja u afrua pranë nxënësve me mendime e sugjerime, duke i përgëzuar për pasionin e pashtershëm e lidhjen e tyre të ngushtë me librin.



Seminar me Z. Qemal Zaimi

Në kuadër të tematikave të trajtuara në lëndën e qytetarisë mbi ligjet dhe funksionimin e gjykatave, kemi pasur nderin të ftonim Z. Qemal Zaimi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit. Në fjalën e tij, Z. Zaimi u përqendrua në rëndësinë e ligjeve dhe institucioneve të drejtësisë në ndërtimin e një shoqërie të rregullt dhe të barabartë.

Ai shpjegoi se funksionimi i gjykatave është thelbësor për zbatimin e ligjeve dhe për t'u siguruar që të drejtat dhe detyrat e qytetarëve respektohen me kujdes.



MUAJJI I ARTIT DHE LETËRSISË



Takim frymëzues me botuesen, znj. Arlinda Duda

Bashkë me nxënësit tanë, patëm kënaqësinë të lundrojmë në botën e librave, lundrim ky i drejtuar me mjeshtëri nga znj. Arlinda Dudaj. Zonja Dudaj na dha më tepër njohuri në lidhje me Festalet letrare, çmimet dhe rëndësinë e tyre.

Gjatë bisedës, zonja Dudaj na shpalosi aspekte të ndryshme të magjisë së të lexuarit, gjë që e bëri këtë seminar mbresëlënës për të gjithë të pranishmit.

Në fund të takimit, nxënëset e Critical Thinking and Creative Club, së bashku me Matean, një nxënëse tepër e talentuar në pikturë, i bënë një surprizë botueses së njohur, Arlinda Dudaj.



Takim frymëzues me autoren Monika Stafa dhe drejtoreshën e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli

Si pjesë e programeve për “Tetori e Librit”, me moton “Fjalë pas fjale”, patëm kënaqësinë të kishim të pranishme në shkollën tonë, autoren Monika Stafa dhe drejtoreshën e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli.

Të ftuarat zhvilluan një bashkëbisedim tepër motivues me nxënësit tanë, duke ndarë me ta përvojat dhe këshillat e tyre në fushën e letërsisë dhe leximit.



Seminar me gazetaren, Znj. Alma Çupi

Në një prej seminareve të shumta që organizon shkolla jonë, patëm një të ftuar tepër speciale, një shpirt të lirë që ka shkelur çdo cep të Shqipërisë, gazetaren e njohur, znj. Alma Çupi. Ajo zhvilloi një bashkëbisedim me nxënësit tanë, duke iu treguar atyre përvojat dhe këshillat e saj personale, të cilat e bënë atë kaq të suksesshme dhe të dashur nga publiku. Gjithashtu, ajo ndau detaje për rrugëtimin e saj në gazetari dhe se si emisioni i saj u kthye në një mision për të.

“Natyra është fuqia më e madhe e secilit prej nesh”. Ishte ky një nga mesazhet e shumta, që na bënë të kuptojmë se Shqipëria është një vend i mrekullueshëm, me plot vlera e tradita. Bashkëbisedimi që interaktiv dhe shumë interesant. Modestia, çiltërsia dhe shumë nota humorit, përbënë kombinimin perfekt që iu servir nxënësve prej saj.



Takim me drejtueset e shtëpisë botuese “Muza”, Klodiana Metani dhe Irma Dudushi

Në kuadër të aktiviteteve të Javës së Gjuhëve të Huaja dhe Ditës Ndërkombëtare të Librit, mirëpritëm në një takim dhe atmosferë shumë të ngrohtë, drejtueset e shtëpisë botuese “Muza”, zonjat e nderuara, Klodiana Metani dhe Irma Dudushi.

Gjuhët e huaja, pikëlidhja e tyre me gjuhën tonë përmes procesit të përkthimit, leximi dhe shumëçka mbi gjuhët dhe librin, u diskutuan në një bisedë të këndshme në ambientet e shkollës. Këtij takimi iu bashkua edhe mësuesja e anglishtes, Irena Rama, e cila këtë herë u prezantua me punën e saj në fushën e përkthimit, përkatësisht me botimin më të fundit nga shtëpia botuese "Muza" të autores holandeze Gerta Blees, ardhur me librin "Ne jemi drita".

Përkthimi është një angazhim i vështirë, por edhe sfidues e i bukur, veçanërisht kur dashuria



për librin dhe pasioni për gjuhët të udhëheqin në misionin tënd.

Ky ishte edhe një ndër mesazhet e përcjella nga ky takim, të cilin nxënësit e pasuruan me mendimin e tyre kritik, të shpalosur me mjaft elokuencë e oratori.

Aktivitet në kuadër të Muajit të Artit dhe të Letërsisë



Në kuadër të Muajit të Artit dhe të Letërsisë, u zhvillua një aktivitet artistik, në të cilin klasat e ndryshme u përfaqësuan me autorët e tyre të preferuar. Nxënësit përgatitën materiale informuese rreth shkrimtarëve të zgjedhur, por edhe rreth filozofisë së tyre krijuese, duke i integruar këto edhe me kostumografinë, për t'i dhënë jetë veprave të tyre. Shoqëruar nga recitimi i nxënësve tanë të talentuar, dramat morën ngjyrat e duhura, për t'iu afruar një shfaqjeje të vërtetë artistike. Jemi falenderues ndaj nxënësve tanë dhe mësueseve të gjuhës shqipe dhe letërsisë (Flora, Rajmonda, Anita dhe Brunilda) për punën e tyre.



Takim me gazetarin Enrik Mehmeti



I ftuar në mjediset e shkollës sonë ishte një ndër gazetarët më të vlerësuar në gazetarinë kombëtare e ndërkombëtare, Z.Enrik Mehmeti, me të cilin u zhvillua një bisedë shumë e ngrohtë me tematikë: "Forca e medias". Nxënësit treguan shumë interes, gjë e cila u vu re edhe në pyetjet e shumta që ata drejtuan. Z.Enrik ndau me nxënësit përvojën e tij personale dhe u foli atyre lidhur me rëndësinë që ka media në Shqipëri e më gjerë.





Takim me violinistin Olen Cesari

Në shkollën tonë, patëm kënaqësinë të prisnim një të ftuar shumë special, një nga violinistët më të mëdhenj në botë, Z. Olen Cesari.

Gjatë bashkëbisedimit me nxënësit, Z.Cesari ndau me ta përvoja dhe këshilla personale në rrugën e artit.

Të ëndërrosh dhe të punosh për realizimin e ëndrrave, ishte ky një nga mesazhet që nxënësit morën gjatë këtij takimi frymëzues, të shoqëruar me pozitivitet dhe thjeshtësi





Udhëtim nëpër botë

Le të festojmë diversitetin!

Nxënësit e klasave të 11-ta, të shkollës së mesme "Turgut Ozal", na çuan në një udhëtim nëpër botë, duke na njohur me traditat e pasura, kulturat, kuzhinën, gjuhët, sportet e vendeve të ndryshme në botë.

Prezantimet e nxënësve ishin një shfaqje e punës së palodhur dhe e kreativitetit, ndaj komisioni i vlerësimit ishte tërësisht i impresionuar.







JAVËT E

SHKENCAVE





Njohja me funksionimin dhe ndërtimin e mëlçisë

Gjatë seancës së radhës të Klubit të Mjekësisë, nxënësit u njohën me funksionin dhe ndërtimin e mëlçisë. Gjithashtu, ata diskutuan rreth studimeve në hepatologji. Në fund të kësaj seance, ata, me ndihmën e mentorit të tyre, profesor Bernardo Nuredinit, zhvilluan një diseksion të organit.



Fakulteti i Mjekësisë pret nxënësit e shkollës ``Turgut Ozal``

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë zhvillan një vizitë në Fakultetin e Mjekësisë. Ata ndoqën një seminar të mbajtur nga profesor Leonard Bërdica, pranë Departamentit të Anatomisë Patologjike. Nxënësit morën informacione të shumta rreth degës së mjekësisë. Ata u informuan për lëndët që zhvillohen në fakultet, për rrugëtimin e vështirësitë e një mjeku në Shqipëri, etj. Një nga pjesët më interesante të kësaj vizite ishte njohja nga afër me disa patologji të anatomisë së njeriut.



Nxënësit e Klubit të Mjekësisë vizituan Klinikën Keit.

Nxënësit e shkollës sonë eksploruan ambientet e klinikës Keit, përfshirë dhe sallën e operacioneve.

Në një bisedë të ngrohtë, nxënësit shpalosën pasionin për mjekësinë, duke diskutuar me doktorin anesteziist.

Në fokus të bisedës ishin sfidat e këtij profesioni, por edhe kënaqësia e padiskutueshme që sjell kujdesi për pacientët. Kjo përvojë e pasur me dije dhe frymëzim, po i aftëson nxënësit tanë për të ardhmen në fushën e mjekësisë.



Nxënësit e Klubit të Mjekësisë vizituan ambientet e CFO-së

Gjatë vizitës në ambientet e CFO-së, nxënësit vëzhguan me kujdes mënyrën e paketimit të ilaçeve dhe organizimin nga robotët, sipas emërtimeve të tyre.

Ata eksploruan edhe ambiente të tjera të kompanisë farmaceutike duke u njohur me proceset inovative të prodhimit.



Pranë ambienteve të Klinikës Gjermane të Syrit

Klubi i Mjekësisë vizitoi gjatë kësaj jave Klinikën Gjermane të Syrit, pranë spitalit "Hygeia". Nxënësit u njohën me Institutin e Oftalmologjisë dhe vizituan kabinetet e këtij instituti. Ata vëzhguan nga afër zhvillimin e një vizitës okulistike dhe ndërhyrjen kirurgjikale Pterigium.

Gjithashtu ata u njohën me aparaturat më të fundit në degën e Oftalmologjisë dhe u informuan mbi vështirësitë e punës së mjekut oftalmolog. I jemi falenderues mjekes Klajda Bardhi, për mikpritjen dhe të gjitha këshillat që ajo ndau me ne, si kirurge pranë kësaj klinike.




Vizitë në Your Medical Clinic

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë patën mundësi që të eksplorojnë fusha të ndryshme të mjekësisë, gjatë vizitës në Your Medical Clinic. Ata vizituan laboratorin, duke u njohur kështu me proceset dhe teknologjitë që përdoren në realizimin e analizave biokimike, hormonale dhe gjenetike.

Gjithashtu, nxënësit u njohën edhe me procedurat e koloniskopisë dhe fibrogastroskopisë.

Biseda me mjekun kirurg, Edmond Çelikun, shënoi një moment të veçantë për nxënësit tanë, duke diskutuar për sfidat dhe arritjet në fushën e mjekësisë.





Vizitë në Spitalin Amerikan 2

Nxënësit e Klubit "Future Medical Professional" zhvilluan një vizitë pranë Spitalit Amerikan 2, ku u pritën nga drejtori, z.Gentian Cako. Gjatë vizitës, nxënësit patën mundësi të bisedonin me mjekë, të njiheshin me procesin e gastero-enteroskopisë dhe të vëzhgonin në departamentin e radiologjisë procedurat që kryhen gjatë rezonancës magnetike.



Njohja me fushën e kardiologjisë - Vizitë në Spitalin Amerikan 3

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë zhvilluan një vizitë pranë Spitalit Amerikan 3, ku njihën më nga afër fushën e kardiologjisë.

Mjeku kardiolog, Indrit Temali, u prezantoi nxënësve ambientet e spitalit, duke i njohur ata edhe me aparaturat e nevojshme për kurimin e sëmundjeve të zemrës.

Nxënësit panë sallat ku zhvilloheshin operacione, grafi, skanera dhe EKG të rrahjeve të zemrës.

Gjithashtu, mjeku zhvilloi një vizitë me një pacient, ne praninë e nxënësve, duke treguar me detaje mënyrën sesi funksionon aparatura e matjes së ritmit të zemrës.



Bisedë me Dr. Eldores Sula

Në vijimësi të aktiviteteve për Javën e Karrierës, Dr. Eldores Sula ishte i ftuar në shkollën tonë, për të diskutuar me nxënësit e interesuar për biologjinë molekulare dhe diversitetin e kësaj fushe.

Nxënësit morën informacione të reja dhe përfituan një këndvështrim tjetër rreth degës së tyre të interesit, falë përvojave që Dr. Sula ndau me ta.



Seminar me mjeken Migena Vargu

"Kudo që dashurohet arti i mjekësisë, ka edhe dashuri për njerëzimin."

Ishte pikërisht ky mesazhi që mjekja e mirënjohur, znj. Migena Vargu, kishte për nxënësit tanë.

Në këtë seminar ajo e kanalizoi fokusin e bisedës, në vlerësimin e pashtershëm që e shoqëron mjekun gjatë gjithë jetës, si dhe në mënyrën se si fitohet ky vlerësim.

Ndonjëherë nuk janë ilaçet që shërojnë. Një fjalë e ngrohtë, një buzëqeshje, një shtrëngim duarsh i japin pacientit fuqinë dhe dëshirën për ta përballuar sëmundjen. Në sytë e çdo pacienti mjeku është hyjni.



Bisedë me Gledis Nanon dhe Dr. Gentjan Skara

Në kuadër të Javës së Karrierës, Gledis Nano dhe Dr. Gentjan Skara ishin të ftuar në shkollën tonë për të zhvilluar një bisedë me nxënësit e interesuar në fushën e drejtësisë dhe kriminologjisë.

Nxënësit dëgjuan me vëmendje, bënë pyetje rreth çështjeve të cilat ngjallin më tepër kuriozitet te ata, duke marrë kështu më shumë informacion nga përvojat dhe njohuritë e të ftuarëve tanë.



Bisedë me Dr. Nertil Mera

Në kuadër të javës së karrierës, Dr. Nertil Mera ishte i ftuar në shkollën tonë për të mbajtur një diskutim me nxënësit tanë të interesuar në fushën e financë-bankës. Të gjithë ata që patën interes të dinin më shumë mbi strategjitë e financimit dhe funksionimin e bankave, patën mundësinë të merrnin informacione nga vetë eksperiencën dhe njohuritë e të ftuarit tonë.



Vizitë në Cambridge Clinical Laboratories

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë vizituan Cambridge Clinical Laboratories.

Ata u njohën me ambientet e ndryshme të laboratorit dhe me mënyrën e funksionimit të aparaturave.

Nxënësit panë më nga afër Pjatat e Petrit, ku grumbullohen dhe rriten bakteret e llojeve të ndryshme.

Mjekja që na priti, zonja Marsela Haruni, i këshilloi nxënësit për kryerjen e vazhdueshme të analizave të gjakut, për të qenë të vetëdijshëm për funksionimin e organizmit të tyre.



Bisede rreth degës së arkitekturës, drejtuar nga Rudina Belba

Nxënësit tanë kaluan një pasdite të pasur me diskutime dhe analiza të detajuara, rreth degës së arkitekturës, drejtuar nga Rudina Belba, arkitekte në Bruklin, Nju Jork.

Një nga çështjet që u trajtua ishte hapësira profesionale, ku u diskutua rreth llojeve të specializime që shtrihen më tepër në përditshmëri, brenda e jashtë vendit.

I jemi mirënjohës zonjës Rudina, për këtë takim frymëzues.



Bisedë me Dr. Irma Gjani

Gjatë Javës së Karrierës, Dr. Irma Gjani ishte e ftuar në shkollën tonë për diskutuar me nxënësit e interesuar rreth degës së farmacisë.

Nxënësit patën mundësi të njihen më gjerësisht me këtë fushë nga një individ kompetent dhe të eksplorojnë mundësitë që ky profesion sjell në rrugëtimin e tyre.



Vizitë në Klinikën Art Orl Clinic

Një vizitë me plot informacione rreth ndërhyrjeve për modelimin e hundës, ishte vizita që nxënësit e Klubit të Mjekësisë zhvilluan në ambientet e Klinikën Art Orl Clinic. Gjatë kësaj vizite, nxënësit panë nga afër zgjimin e pacientit pas operacionit, intubimin dhe procesin e ndërhyrjes për modelimin e hundës.

Ishte mikpritja e Dr. Besim Boçit dhe Dr. Artur Hatias, që bënë të mundur realizimin e kësaj përvoje kaq interesante.



Vizitë në Spitalin e Traumës, në Tiranë.

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë vizituan Spitalin e Traumës, në Tiranë. Gjatë kësaj vizite, ata patën mundësi të takonin ish-drejtorin e spitalit, Z. Arben Zenelaj dhe dermatologun, Znj. Valbona Zenelaj.

Z. Arben i udhëhoqi nxënësit në një tur nëpër ambientet e spitalit, përfshirë edhe dhomën e operacionit, duke u treguar pajisjet e nevojshme që përdoren gjatë një operacionit.

Nga ana tjetër, dermatologia ndau me nxënësit tanë njohuri të vlefshme, duke u treguar atyre pajisjet që përdoren në identifikimin e problemeve dermatologjike dhe promovimin e rutinave të kujdesit. Kjo ishte një përvojë e jashtëzakonshme për nxënësit tanë!



JAVËT E SHKENCAVE SOCIALE

TURKUT OZAL
EDUCATION COMPANY

TURKUT OZAL
SCHOOL TIRANA
1997



Takim me arkeologun e njohur, Z. Jani Koçillarin

Shkolla jonë u dha mundësi nxënësve për një bashkëbisedim me arkeologun dhe pedagogun e mirënjohur, z. Jani Koçillari.

Z. Koçillari u foli nxënësve për mjetet e punës së një arkeologu, për mënyrat e hulumtimeve e gërmimeve arkeologjike, për zonat në të cilat arkeologët po gërmojnë aktualisht etj., duke zbuluar kështu më shumë për zhvillimin e arkeologjisë në vendin tonë.

"Të fuqizuar nga dijet, të bashkuar kundër bullizmit."

Në kuadër të aktiviteteve ndërgjegjësuese kundër bullizmit, u zhvillua trajnimi i radhës në kolegjin "Turgut Ozal", nga organizata "Perspektiva".

Ky trajnim ishte një rikujtesë e fuqishme se arsimi është arma jonë më e fortë, në luftën kundër bullizmit.

Në këtë trajnim dyditor, nxënësit mësuuan më tepër rreth bullizmit kibernetik (cyberbulling), diskriminimit, efekteve të përdorimit të substancave psiko-aktive, dhunës të rinjtë etj. Le të qëndrojmë së bashku, për një botë pa urrejtje!



Awareness Club, një zë frymëzues

Awareness Club zhvilloi një seminar me nxënësit e klasave të 8-ta, me temë: "Book Therapy". Ky seminar kishte si qëllim që nxënësit të njihen me dobitë e leximit të librave dhe të gjejnë veten mes rreshtave. Ishte një përvojë shumë e bukur, tek shikoje dëshirën e nxënësve për të ndihmuar njëri-tjetrin.





Pranë ambienteve të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë

Një nga tematikat e rëndësishme të Klubit Global Perspectives është edhe njohja me institucionet arsimore dhe funksionimin e tyre në Shqipëri.

Nxënësit e klubit realizuan #geoday, një ditë në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, ku u njohën me bibliotekën e dytë më të madhe në Shqipëri, me ambientet dhe sallat e studimit dhe morën pjesë në seminarin me temë: " Të studiosh gjeografi". Në këtë seminar nxënësit treguan mjaft interes, duke marrë pjesë në mënyrë cilësore në diskutime.

Shprehim mirënjohjen për Prof.dr Romeo Hanxharin dhe PhD Cand Ornela Hasramën që morën përsipër organizimin e këtij aktiviteti.

Bashkëbisedim me prof. Niuton Mulleti

Nxënësit e International Relations and Politics Club patën kënaqësinë të bashkëbisedonin, në ambientet e Universitetit Epoka, me prof. Niuton Mulleti, rreth marrëdhënieve gjeopolitike të shteteve dhe historisë së formimit të shkencave politike. Bashkëbisedimi ishte mjaft interaktiv, sepse nxënësit e klubit bënë pyetje të ndryshme dhe morën përgjigje për situatat politike globale, të ditëve të sotme.





Seminar për Ditën e Tokës

Nxënësit e klasave të 10-ta zhvilluan një seminar në kuadër të Ditës së Tokës, me ambientalistin dhe gjeologun e njohur shqiptar, Z. Sazan Guri.

Nxënësit u njohën me situatat mjedisore, problematikat më të mëdha, rastet më urgjente për shpëtimin e florës/faunës, habitateve ujore etj, në Shqipëri dhe në botë.

Seminari ishte interaktiv e plot diskutime frytdhënëse.



Seminar nga Prof. Asoc. Majlinda Keta

Në vijimësi të Javës së Shkencave Sociale nxënësit e klasës së njëmbëdhjetë patën kënaqësinë të bashkëbisedonin me lektoren e Departamentit të Filozofisë në Universitetin e Tiranës, Prof. Asoc. Majlinda Keta.

Znj. Keta, përmes një dialogu të natyrshëm, theksoi domosdoshmërinë e disiplinave filozofike në progresin human e shoqëror. Thelbi i dialogut: Të filozofosh, sa dhe si filozofojmë?, i nxiti nxënësit tanë që të kuptojnë nevojën e filozofisë dhe dimensioneve të saj në jetën e tyre.



Kujdesi për shëndetin mendor është jetik

Shëndeti mendor është një aspekt i rëndësishëm i mirëqenies së përgjithshme, që ndikon në performancën, sjelljen dhe qëndrimin tonë ndaj jetës.

Në ditët e sotme kujdesi për shëndetin mendor po merr gjithnjë e më shumë vëmendje, duke u vlerësuar si një pjesë kyçe për një jetë të shëndetshme.

Patëm kënaqësin të kishim të ftuar në shkollën tonë Dr. Brikena Allkon, specialiste në Shërbimin e Psikiatrisë Infantile, për të na folur rreth sfidave që adoleshentët kalojnë në këtë fazë të jetës dhe rreth mënyrës se si ata mund ta përballojnë këtë tranzicion të rëndësishëm. Këshillat ishin shumë të nevojshme e të vlefshme, prandaj u pritën shumë mirë nga nxënësit tanë.



Aktivitet i zhvilluar nga Prof. As. i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Z. Mihallaq Qirjo

The Social Sciences Week vijoi me një aktivitet të zhvilluar nga Prof. As. i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Z. Mihallaq Qirjo dhe njëkohësisht drejtues i REC Albania (Qendra Burimore e Mjedisit) me praninë e përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë, në kuadër të projektit të BE-së, Kryeqytetet bashkëpunojnë. Seminari interaktiv me temë "Konsumizmi, zhvillimi (jo) i qëndrueshëm dhe gjurma ekologjike" ngjalli kuriozitetin e nxënësve dhe nxiti ndërgjegjësimin mjedisor tek ta.



Vizitë në Institutin e Fëmijëve që nuk dëgjojnë

Vizita në Institutin e Fëmijëve që nuk dëgjojnë ishte një përvojë jashtëzakonisht frymëzuese për Klubin e Ndërgjegjësimit dhe Klubin Shpresa! Në këtë ambient të mbushur me kujdes dhe përkushtim, u njohëm me mënyrat e tyre unike të mësimit.

Nisur nga komunikimi nëpërmjet gjuhës së shenjave deri te kreativiteti i tyre artistik, u zhytem në një botë të re të zbulimeve dhe përpjekjeve të pafundme. Kjo vizitë na bëri të ndjehemi pjesë e një rrugëtimi frymëzues drejt shkëlqimit personal dhe profesional.

Mirënjohje për mikpritjen e ngrohtë dhe përvojën e paharrueshme që fëmijët dhe stafi i Institutit na ofruan!



Bisede me Z. Aljaz Kuncic, Economics for Development në UN Albania

Në vazhdimësi të aktiviteteve të Muajit të Historisë dhe Gjeografisë, si dhe në kuadër të tematikave të International Relations and Politics Club, në shkollën tonë kishim të ftuar Z. Aljaz Kuncic, Economics for Development në UN Albania.

Z. Kuncic u foli nxënësve rreth objektivave për zhvillim të qëndrueshëm, rreth asaj se çfarë mund të bëjmë ne si shoqëri për të përparuar, si dhe rreth mënyrës se si këto objektiva mund të aplikohen në Shqipëri.



Bashkëbisedim në Ditën e Familjes

Në Ditën e Familjes, u zhvillua një bashkëbisedim për t'u ndërgjegjësuar për rolin e familjes në jetën tonë.

Jemi shumë të lumtur që në panelin e shkollës sonë kishim pjesëmarrës nga tre breza, për të ndarë përvojat e tyre, mençurinë e moshës dhe perceptimin për familjen.

Në këtë bisedë u njohëm me guximin dhe shpirtin luftarak të një nënë për të përballur sfidat e karrierës dhe të familjes, si edhe me talentin e mprehtësinë e brezit të ri për të ekuilibruar dinamikat dhe për të jetuar mes vlerave dhe parimeve.

Falenderim të veçantë për mësuesen tonë, Enverie Bitri, për zonjën Irida Shulku, prind i shkollës sonë, dhe nxënësen maturantë, Vesa Çelikun.




Ndërgjegjësohemi për shëndetin mendor

Nxënësit tanë të talentuar e kaluan ditën në natyrë, duke eksploruar fuqinë e artit për të shprehur ndjenjat dhe për të promovuar mirëqenien mendore.

Terapia e artit është një udhëtim krijues drejt paqes dhe lumturisë së brendshme.





OLIMPIADA, PROJEKTE DHE KONKURSE



Konkursi i Letërsisë: Të mësuarit përmes garës

Në kuadër të Muajit të Artit dhe të Letërsisë, mes klasave të 12-ta u zhvillua Konkursi i Letërsisë, duke krijuar kështu një mjedis miqësor dhe bashkëpunues. Nxënësit dëshmuuan njohuritë dhe aftësitë e tyre në lëndën e Letërsisë, por gjithashtu edhe dashurinë për artin e fjalës. Fitues të konkursit u shpallën nxënësit e klasës XII-B.

Konkursi i Projekteve 3D

Nxënësit e klasës së 10-të morën pjesë në Konkursin e Projekteve 3D, të ndërtuara prej burimeve të riciklueshme. Në kohën kur planeti ynë po përjeton ndryshime të mëdha mjedisore, përdorimi i burimeve të riciklueshme është kthesa që ne duhet të marrim. Përveç pamjes së jashtme të përkryer, projektet ishin të fokusuar në efikasitetin dhe përdorimin e zgjuar të burimeve. Duke aplikuar teknologjinë e fundit për menaxhimin e energjisë, ne kemi krijuar një model për të ndërtuar të ardhmen, duke u kujdesur për mjedisin.



Finalja e Tavolinës së Debatit

"Ushtari mund ta fitojë luftën në fushën e betejës, por një mësues e fiton atë ende pa nisur". Me këtë mesazh sensibilizues u mbyll cikli i takimeve në "Tavolinën e debatit". Takimi final i këtij konkursi u zhvillua mes klasës XII-D dhe klasës XII-C. Mes shumë emocioneve, qëndrimeve të argumentesh të zjarrta, ky konkurs u përmbyll me fitoren e klasës 12-D.





Momente krenarie për gjimnazin “Turgut Ozal”!

15 maturantë tanë, të vitit të kaluar, u nderuan me medalje të arta nga kryeministri.

Në një ceremoni të veçantë në Kryeministri, ku morën pjesë edhe ministrja e Arsimit dhe Sportit, si dhe ministrja e Rinisë dhe Fëmijëve, maturantët tanë u nderuan për arritjet e tyre të jashtëzakonshme, si në provimet e shkollës së mesme, ashtu edhe në provimet e maturës.

Shkolla e mesme “Turgut Ozal” mban me krenari titullin e shkollës së parë në Shqipëri, për numrin më të madh të fituesve të medaljeve të arta për vitin e kaluar.

Le të shprehim urimet tona të përzemërta për nxënësit fitues dhe t’u urojmë atyre suksese të vazhdueshme në rrugëtimet e tyre universitare!



Fituesit e universiteteve më të mira vizitë te “Rudina”

Të pranuar në universitetet më të mira në botë, maturantët Moana Gorezi, Orkida Jahja dhe Bergi Avdulaj ishin pjesë e emisionit të pasdites “Rudina”, të prezantuar nga moderatorja më e njohur e ekranit shqiptar, Rudina Magjistari, në Tv Klan, për të folur për rrugëtimin e tyre drejt majave.

Shërbimi më i madh që mund t’i bëhet të ardhmes së një kombi, është arsimimi e edukimi i të rinjve të tij me vlera të larta morali dhe synime të mëdha për transformim shoqëror, ndaj, në shkollën “Turgut Ozal”, prej vitesh u ofrohet nxënësve një mësimdhënie cilësore, duke i bërë ata të suksesshëm anëmbanë botës.

Shkolla e mesme “Turgut Ozal”, aty ku suksesi është traditë!



Konkursi i Historisë mes klasave të 11-ta

Nxënësit e klasave të 11-ta u bënë pjesë e Konkursit të Historisë.

Ata u përballën me pyetje për lashtësinë, antikitetin dhe mesjetën shqiptare.

Ky konkurs u organizua me profesionalizëm nga mësuesit, Ilir Velo dhe Haxhire Lleshi.

Në fund të kësaj sfide u kurorëzuan me fitore tri klasa.

Vendin e parë e fitoi klasa XI-D, vendin e dytë klasa XI-H dhe vendin e tretë klasa XI-I.

Konkursi i Fizikës

Në raundin e parë të Konkursit të Fizikës, nxënësit tanë patën një performancë të jashtëzakonshme! Ekipi i shkollës sonë doli fitimtar, duke hapur rrugën për të konkurruar më tej kundër mendjeve të tjera të ndritura, nga vende të tjera, në raundin e ardhshëm.



Nxënësi Nio Mullanji bëhet pjesë e aktivitetit LevelUP

Nxënësi ynë, Nio Mullanji, mori pjesë në aktivitetin LevelUP, të organizuar nga European Youth Forum, në datat 12-13 Prill, në Parlamentin Europian në Bruksel.

Mbi 1200 aktivistë të rinj, nga e gjithë Europa, patën mundësi për të diskutuar, për të shkëmbyer ide dhe për të nxitur aktivizmin e të rinjve, që të marrin pjesë në zgjedhje dhe në politika rinore.


Nio mori titullin Democracy Ambassador.





FIRST LEGO LEAGUE

Ekipet e Robotikës së shkollës sonë kanë marrë pjesë në kompeticionin FIRST LEGO LEAGUE ALBANIA 2023 dhe kanë fituar një medalje të artë dhe një medalje argjendi. Në shkollën tonë, Robotika është një pjesë integrale e programit jashtëshkollor, ku nxënësit mësojnë se si të dizajnojnë dhe programojnë robotë. Ekipet tona punuan shumë për t'u përgatitur për garën dhe suksesi i tyre është një dëshmi e përkushtimit dhe angazhimit të tyre.



Olimpiada Ndërkombëtare Purple Math Comet

Integrimi i nxënësve në botën e shkencës dhe matematikës, arrihet nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kjo është arsyeja se përse ekipi lëndor i matematikës, i jep një rëndësi të veçantë platformave dhe konkurseve të ndryshme. Në ambientet e shkollës sonë, është zhvilluar Olimpiada Ndërkombëtare Purple Math Comet.

Nxënësit e klasave të 10-ta, kanë konkurruar me njëri-tjetrin të organizuar në grupe, por edhe me grupe të tjera ndërkombëtare.



Konkursi Trivia gjatë Javës së Shkencave

Konkursi Trivia u zhvillua në shkollën tonë gjatë Javës së Shkencave dhe rezultoi një sukses i madh!

Krenarë për pjesëmarrësit, që vunë në provë njohuritë e tyre shkencore dhe konkurruan në kategori të ndryshme dhe falenderues ndaj departamentin të shkencave, që e bënë këtë konkurs një përvojë të paharrueshme për nxënësit tanë.



Kampionati i Shahut

Kampionati i Shahut është një nga aktivitetet më interesante që shkolla organizon, sepse përveç argëtimit, zhvillon strategji e taktika të të menduarit, për t'u përballur me rivalët në lojë. Përballjet e këtij viti nxorrën fitues nxënësin e klasës së 11-të, Albion Qojle.



International Genius Olympiads

Nxënësit tanë kanë udhëtuar për në SHBA për të marrë pjesë në Olimpiadat Ndërkombëtare të Gjenit (International Genius Olympiads). Ata garuan me gjimnazistë të tjerë nga 70 vende të ndryshme të botës. Jemi shumë krenarë për arritjen e tyre!.

Fundjava e pabesueshme e ASEF-it

U zhvillua sërish Konkursi i 22-të i Projekteve të Kategorive Sociale ASEF (Panairi Shqiptar i Shkencës dhe Inxhinierisë) në Tiranë!

Shkolla jonë prezantoi me krenari plot 96 projekte cilësore. Këtë vit konkurrenca ishte `e ashpër`, me gjithsej 700 projekte nga Shqipëria dhe Kosova.

Përkushtimi i nxënësve tanë solli 69 medalje në shkollën tonë!

Mirënjohje e përzemërt për të gjithë pjesëmarrësit, mësuesit dhe organizatorët që e bënë këtë ngjarje një sukses të jashtëzakonshëm.



Fitues në Olimpiadën Ballkanike të Fizikës

Jemi shumë krenarë që nxënësit tanë përfaqësuan shkollën dhe kombin tonë në Olimpiadën Ballkanike të Fizikës!

Një përgëzim i veçantë për Mishel Ballën, i cili fitoi medaljen e nderit!

Kjo arritje nxjerr në pah përkushtimin, punën e palodhur dhe talentin e jashtëzakonshëm të nxënësve në fizikë.



Triumfues në Olimpiadën Ballkanike të Shkencave

Shkolla jonë u ndje krenare për të gjithë fituesit e Raundit të Parë Kombëtar, të Olimpiadës Ballkanike të Shkencave, në Biologji dhe Fizikë! Përkushtimi dhe pasioni i nxënësve tanë për shkencën, kanë bërë të mundur që ata të shkëlqejnë.



Të bëjmë një ndryshim së bashku!

Jemi të emocionuar të ndajmë me ju një histori frymëzuese të dhembshurisë dhe shpirtit bujar të komunitetit!

Kohët e fundit, ne u mbledhëm së bashku, nxënës dhe mësues, për të drejtuar një fushatë të përzemërt që çoi në hapjen e një pusi uji, në një shkollë fshati afër Mombasës, në Kenia.

Më parë kjo shkollë nuk kishte akses në ujë të pijshëm të pastër, por falë kontributeve bujare të të gjithëve, kjo gjë tashme ka ndryshuar.

Ishte thellësisht prekëse të dëshmosh gezimin dhe mirënjohjen e çiltër në sytë e nxënësve, teksa ata përjetuan për herë të parë ndikimin e madh që ka uji i pastër në jetën e tyre.

Ky projekt jo vetëm që ka siguruar burime thelbësore jetësore, por gjithashtu na ka mësuar fuqinë e unitetit dhe ndikimin e jashtëzakonshëm që mund të kemi kur punojmë së bashku.

Faleminderit të gjithë atyre që e bënë të mundur këtë gjë!

Le të vazhdojmë ta bëjmë botën një vend më të mirë, hap pas hapi!





KËSHILLIM DHE KARRIERË



**REZULTATET DHE DESTINACIONET 2023-2025**

UNIVERSITY	WORLD RANK	REGIONAL RANK	COUNTRY	STUDENTS ENROLLED
Harvard University	1	1	USA	1
Bocconi University	16	4	Italy	6
University of Toronto	18	1	Canada	1
New York Institute of Technology	22	15	USA	1
Technical University of Munich	30	1	Germany	4
LMU Munich	33	2	Germany	1
Central European University Austria	34	3	Austria	1
Kings College London	35	6	UK	2
Georgia TECH	36	4	USA	1
Business & Hotel Management School	40	10	Switzerland	1
EU Business School	42	11	Spain	1
KU Leuven	50	1	Belgium	1
Marangoni Fashion Institute	51	9	Italy	1
University of Amsterdam	60	1	Netherlands	1
Miami Dade College	66	18	USA	1
Utrecht University	66	3	Netherlands	3
University of Birmingham	80	12	UK	1
Radboud University	117	7	Netherlands	1
Vrije Universiteit Amsterdam	121	8	Netherlands	1
University of Massachusetts Boston-UMASS	123	96	USA	2
University of Vienna	124	1	Austria	1
Fordham University	125	33	USA	1
University of Basel	131	6	Switzerland	1
Maastricht University	145	10	Netherlands	2
IT University of Copenhagen	151	8	Denmark	1
Bonn University	157	7	Germany	1
The University of Wollongong	162	12	United Arab Emirates	1
Vienna University of Economics and Business	167	9	Austria	1



Lausanne University	180	7	Switzerland	1
Eindhoven University of Technology	201	11	Netherlands	1
IE University	201	31	Spain	1
University of Padua	203	3	Italy	2
University of Turin	221	7	Italy	1
Frankfurt University	227	14	Germany	1
Luiss Guido Carli	233	37	Italy	7
Fairleigh Dickinson University (New Jersey)	235	60	USA	1
Semmelweis University	236	2	Hungary	2
Universite Grenoble Alpes	237	7	France	1
Tilburg University	251	12	Netherlands	1
University of Twente	252	13	Netherlands	2
Medical University of Vienna	278	2	Austria	1
FAU (Erlangen-Nürnberg)	281	18	Germany	1
Drexel University	301	220	USA	2
Duisburg University Essen	306	21	Germany	1
Politecnico di Milano	310	14	Italy	2
Università Cattolica del Sacro Cuore	341	23	Italy	3
Sabancı University	351	6	Turkey	1
City, London University	352	39	UK	2
Constructor University	401	101	Germany	13
Johannes Kepler University Linz	401	10	Austria	2
University of Greenwich	501	110	UK	2
Coventry University	531	13	UK	1
Hunter College	663	27	USA	2
Loyola University Chicago	692	131	USA	1
Westminster University	741	68	UK	2
Bucknell University	981	31	USA	1

Takim me Z. Craig Wilson, CEO I CATS Global Schools

Shkolla jonë pati kënaqësinë të presë Z. Craig Wilson, CEO i CATS Global Schools.

Z. Wilson, i cili është diplomuar dhe ka kryer doktoraturën në Universitetin e Oksfordit, ndau me nxënësit tanë përvoja rreth rrugëtimit të tij në këtë universitet prestigjioz. Gjithashtu, ai dha informacione edhe për programet e ndryshme që ofrohen në shkollat CATS. Grupi CATS Schools është një nga grupet e shkollave më prestigjioze në botë, me më shumë se 18000 nxënës dhe 13 shkolla, në 3 kontinente. Falë partneritetit që shkolla jonë ka me shkollat CATS, nxënësit tanë mund të studiojnë lehtësisht në Angli ose SHBA, në një nga programet që ata ofrojnë, përfshirë edhe Programet A Level.



Seminar me përfaqësues të Northwest University



Shkolla jonë u dha mundësi nxënësve që duan të studiojnë në SHBA, të ishin pjesë e një seminari të organizuar nga përfaqësues të Northwest University në Missiouri, seminar i cili u zhvillua në mjediset e American Corner, në Bibliotekën Kombëtare. Nxënësit u interesuan duke bërë pyetje nga më të ndryshmet dhe duke zbuluar kështu më shumë, për një nga universitetet që ata mund të aplikojnë në të ardhmen





Takim me profesorë të Kolegjit Universitar Beder

Në një seminar tepër të veçantë, të organizuar nga shkolla jonë, patëm kënaqësinë të kishim të pranishëm tre profesorë të Kolegjit Universitar Beder, Dr. Erlis Çelën, Dr. Ana Këkezin dhe Dr. Ada Guvën.

Në këtë seminar nxënësit patën mundësi të bëjnë pyetje dhe të marrin shumë njohuri rreth dy prej fushave më aktuale: Marketingut dhe Medias.

Të ftuarit, specialistë të këtyre fushave, ndanë me nxënësit përvojat e karrieres së tyre, duke u bërë frymëzim edhe për ata të cilët të ardhmen e tyre do e drejtojnë në degët e medias, lidershipit apo marketingut. Gjithashtu në seminar u diskutua edhe rreth Juridikut, që çdo ditë e më tepër po tërheq të rinjtë.

Shkolla jonë pret për vizitë ekipin e menaxhimit të Universitetit Epoka



Në kuadër të aktiviteteve të Javës së Karrierës, patëm kënaqësinë që të presim në shkollën tonë, ekipin e menaxhimit të Universitetit Epoka. Ky ekip, i përbërë nga rektori, dekanët, administratori dhe anëtarë të tjerë të stafit, vizitoi klasat e 12-ta, duke u takuar me maturantët tanë.

Ata e mbyllën vizitën e tyre me një drekë me ekipin drejtues të shkollës sonë.





Takim me Aida Hudhrin, Këshilltare për Arsimin pranë Ambasadës së SHBA-së në Tiranë

Java e Karrierës u bë edhe më emocionuese, sepse ne ishim të nderuar të prisnim në ambientet e shkollës sonë, Këshilltaren për Arsimin nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë, Aida Hudhrin. Gjatë vizitës së saj, ajo mbajti një seminar interaktiv me nxënësit tanë, duke ndarë njohuri rreth sistemin arsimor në SHBA dhe rreth aplikimeve në universitete. Nxënësit morën njohuri të vlefshme dhe patën mundësinë për të bërë edhe pyetje. Duke i uruar nxënësit tanë fitues të Konkursit të Debatit që u zhvillua në shkollë, zonja Hudhri u shpërndau atyre certifikatat.



Vizitë nga përfaqësuesit e Universitetit Webster

Ishte kënaqësi e madhe të prisnim në shkollën tonë përfaqësues nga Universiteti Webster. Universiteti Webster është një institucion jofitimprurës me mbi 100 vjet përvojë në shërbim të studentëve në 50 kampuse në mbarë botën, dhe ne jemi të kënaqur që kemi krijuar një partneritet me ta. Gjatë vizitës së tyre, përfaqësuesit nga Universiteti Webster mbajtën një seminar informues për nxënësit tanë, duke ndarë njohuri për programet e tyre akademike, kërkesat për pranim dhe jetën e kampusit. Nxënësit patën mundësi që të bëjnë pyetje dhe të mësojnë më shumë rreth mundësive unike të disponueshme në Universitetin Webster. Ne besojmë se ky partneritet do t'u ofrojë nxënësve tanë një mundësi të shkëlqyer për të eksploruar opsionet e tyre akademike, për të fituar një perspektivë globale dhe për të arritur qëllimet e tyre arsimore. Ndaj jemi të ngazëllyer që vazhdojmë të punojmë me Universitetin Webster, për t'u ofruar nxënësve tanë burimet që u nevojiten për të pasur sukses.





Vizitë nga përfaqësues të Universitetit Kembrixh, për procesin e akreditimit

Lajm emocionues!

Shkolla jonë pati nderin të priste sot për vizitë përfaqësues nga Universiteti i Kembrixhit, për procesin e akreditimit.

Ky është një moment historik për shkollën tonë dhe ne jemi të emocionuar të ndajmë me ju faktin se, z. Martin Nuttall, Drejtues i Partneriteteve dhe Projekteve dhe Znj. Teresa Okrasinska, Konsulente në Shtypin dhe Vlerësimin e Universitetit të Kembrixhit, ishin të impresionuar me atë që panë.

Ata patën mundësinë të takoheshin me Ekipin Drejtues të shkollës sonë, mësuesit e nxënësit dhe të vizitonin klasat e mjediset tona.

Jemi krenarë të njoftojmë se tani do të jemi në gjendje të ofrojmë të gjitha kualifikimet ndërkombëtare nga Universiteti i Kembrixhit, duke filluar nga viti i ardhshëm. Kjo është një arritje e madhe për shkollën tonë dhe ne jemi mirënjohës për mundësinë që na u dha, për t'iu ofruar nxënësve tanë arsimin më cilësor.



Përfaqësues të CATS Cambridge vizitojnë shkollën tonë

Shkolla jonë pati kënaqësinë të presë një të ftuar special nga CATS Global Schools, Z. Dominic, drejtor i shkollës së CATS Cambridge. Ai drejtoi një seminar tërheqës për nxënësit tanë, duke hedhur dritë mbi mundësitë e jashtëzakonshme për të studiuar në MB, me fokus të veçantë në Shkenca Kompjuterike, Robotikë dhe Inxhinieri. Nxënësit tanë u frymëzuan dhe u motivuar për t'i eksploruar këto fusha. I jemi mirënjohës zotit Dominic për kohën që na kushtoi.



Seminar me Ana Mullanjin, përfaqësuese e Erasmus

Ana Mullanji, drejtuese e organizatës rinore Përtej Barrierave e Pikës së Kontaktit për programet e BE-së, Erasmus+ Rinia dhe European Solidarity Corps, bëri një prezantim për filozofinë, qëllimin dhe aksionet kryesore të programit më të madh evropian të edukimit, Erasmus+, në të cilat merr pjesë vendi ynë. Këto programe i kushtojnë një rëndësi të veçantë rritjes personale dhe sociale të individëve në edukimin formal dhe joformal, në trajnim, sport dhe vullnetarizëm.

Më me hollësi u prezantuan aktivitetet, në të cilat marrin pjesë të rinjtë e grupmoshës 15-18 vjeç.



Bisedë me ish-nxënësin e shkollës sonë, Kristi Bushin

Kristi Bushi, ish-nxënës i shkollës sonë, sot studion në një nga universitetet më të mira në Teksas, në degën e mjekësisë.

I rikthyer në gjimnaz, tashmë si i ftuar, Kristi hëdau me nxënësit e Klubit të Mjekësisë përvojën 3-vjeçare të studimeve të tij, për të arritur drejt fushës së mjekësisë.

Ai dha informacione për një aplikim sa më të suksesshëm dhe na tregoi që çdo sfidë mund të tejkalohet me përkushtim dhe vullnet.



Java e Karrierës, 2024

Java e Karrierës, 2024, u mbyll me sukses.

Aktiviteti përmbyllës u soll nëpërmjet hapjes së standave nga 13 universitete prestigjioze, brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë aktivitet, përveç Epoka University, partnerit tonë të mirënjohur, morën pjesë prej vendeve të ndryshme të Europës, universitete prestigjioze si: Webster University, Constructor University, Bocconi, EHL, WUAS, RIT, etj.

Nxënësit e shkollës sonë patën mundësi që të diskutojnë nga afër, të pyesin e marrin informacione nga vetë përfaqësuesit e këtyre universiteteve.

Një falenderim i veçantë për secilin universitet, që, pavarësisht axhendave të ngjeshura, pranuan ftesën e Turgut Ozal High School dhe morën pjesë në një aktivitet që hap dyer të shumta mundësish për nxënësit tanë.





KLUBE





Vizitë në Muzeun e Forcave të Armatosura

Nxënësit e Klubit Global Perspectives dhe Klubit Critical Thinking vizituan Muzeun e Forcave të Armatosura, në Ministrinë e Mbrojtjes. MFA është muze tipologjik që pasqyron ngjarjet më të rëndësishme ushtarake, por edhe vlerat më të mira të trashëguara nga kombi ynë gjatë historisë së tij, ndër shekuj.

Takim me Z. Murat Sahin

Nxënësit e Klubit të Politikave Ndërkombëtare dhe Klubit të Karrierës, zhvilluan një takim frymëzues me z. Murat Sahin, përfaqësuesin e UNICEF Albania. Gjatë këtij takimi, nxënësit u njohën me projektet dhe punën e UNICEF-it dhe patën mundësi të bisedojnë drejtpërdrejtë me z. Sahin.

Ai foli rreth rolit dhe përvojës së tij në UNICEF, duke na frymëzuar për angazhimin dhe kontributin tonë në drejtim të një bote më të mirë, për fëmijët.

UNICEF for every child!





Seminar me Z. Leons Hasani

"Ndikimi i sektorit bujqësor në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë", ishte tema që u mbajt nga pedagogu Leons Hasani, për nxënësit e Klubit Global Perspectives dhe Klubit të Historisë.

Gjatë seminarit nxënësit drejtuan pyetje në lidhje me problematikat, të ardhmen dhe mundësitë e përfshirjes së tyre në aktivitetet e sektorit të parë ekonomik.

Takim me poetin dhe dramaturgun arbëresh, Mario Caliva

Klubi i Historisë, Klubi National Geographics dhe Klubi i Ndërgjegjësimit u takuan me poetin dhe dramaturgun arbëresh, Mario Caliva, në mjediset e Kolegjit "Turgut Ozal".

Historia e emigrimit të arbëreshëve, kostumet popullore që përdoren në Hora të arbëreshëve, poezitë e të ftuarit të recituara nga nxënësit tanë, pyetjet e nxënësve dhe përgjigjet e Z. Mario, shuan kureshtjen e pjesëmarrësve, por dhe krijuan ide për projekte të reja në të ardhmen.



International Relations and Politics Club mban seminar për nxënësit e klasave të 6-ta

"Procesi i votimit dhe rëndësia e tij, jo vetëm në politikë".

Kjo ishte tema e përgatitur nga nxënësit e Klubit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Politike. Prezantimi u bë para klasave të 6-ta, në Turgut Ozal.

Seminari nisi me një shpjegim të shkurtër të procesit të votimit dhe rëndësisë së tij. Më pas, sipas udhëzimeve, nxënësit votuan për temën e debatit që ata dëshironin për diskutim.

Pasi u vendos me vota tema e diskutimit, nxënësit u ndanë në dy grupe, pro dhe kundër, duke mbajtur qëndrim me argumente, në lidhje me temën.

Në fund u votua për palën fituese.





Takim me Znj. Kamela Hasko

Klubi i Ekonomisë priti në shkollën tonë, znj. Kamela Hasko, audituese ligjore e zyrës së kontabilitetit AKH, për një bashkëbisedimin në lidhje me punën dhe profesionin e ekonomistëve, kontabilistëve dhe audituesit ligjor, me nxënës të Klubit të Ekonomisë dhe Programimit.



Vizitë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë zhvilluan një vizitë pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza".

Gjatë vizitës, nën kujdesin e mjekes Matilda Imeraj, nxënësit u njohën me historikun e godinat e spitalit dhe vizituan pavijonin e nefrologjisë. Ata u njohën me analizat, trajtimin e dializës dhe shërbimet e tjera që realizoheshin në këtë pavijon.



Vizitë në Universitetin Epoka

Klubi i Arkitekturës vizitoi Universitetin Epoka. Takimi me përgjegjësit e departamentit dhe pedagogët, ndihmoi nxënësit për t'u orientuar drejt zgjedhjes së tyre në të ardhmen.

Nxënësit u impresionuan nga projektet e studentëve dhe nga struktura e krijuar e departamentit të arkitekturës.

Vizitë në “AKH Consulting”

Klubi i Ekonomisë vizitoi zyrën e kontabilitetit “AKH Consulting”, për t’u informuar rreth mënyrës se si punojnë ekonomistët në përditshmëri.

Ata u pritën dhe morën informacione të shumta nga Znj Kamela Hasko.



Vizitë në ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Në kuadër të tematikave të International Relations and Politics Club, nxënësit vizituan ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ata u njohën më nga afër me ambientet, ku diskutohen çështje të ndryshme ligjore dhe mësuan më shumë për sistemin demokratik dhe rolin e Kuvendit.



Vizitë në Durrës pranë stacionit të trenit në ndërtim!

Klubi i Inxhinierisë zhvilloi një seancë fantastike në terren, me inxhinierin e ndërtimit, Z. Nikolin Braho, i cili na ndihmoi për të kuptuar e zbërthyer mrekullitë inxhinierike që mbajnë shinat.





Takim me përfaqësues nga Ambasada Amerikane, Chad Twitty - Public Affairs Officer

Takimin e radhës në shkollën tonë e patëm me përfaqësues nga Ambasada Amerikane, Chad Twitty - Public Affairs Officer.

Seminari i zhvilluar ishte plot ngjyra, informacione dhe shkëmbime idesh rreth fushës së diplomacisë dhe rreth avantazheve dhe disavantazheve të procesit të punës në vende të ndryshme.

Nxënësit patën mundësi të shuajnë kureshtjen për tema të ndryshme, duke u bërë pjesë në mënyrë aktive në diskutime.



Vizitë në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit


Nxënësit e Global Perspectives Club dhe nxënësit e Klubit të Historisë, vizituan sot ambientet e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, ku u pritën nga Zv.Dekania për marrëdhëniet me institucionet dhe publikun, Prof. Asoc Irma Tabaku.

Nxënësit, gjatë seminarit, patën mundësi të njiheshin me programet e studimit. Gjithashtu, ata vizituan bibliotekën e fakultetit dhe kopshtin botanik.



Vizitë pranë Klinikës Dentare "Vraja"

Vizita e radhës e Klubit të Mjekësisë u realizua pranë Klinikës Dentare "Vraja". Nën drejtimin e mjekes, Armela Musho, nxënësit u njohën nga afër me mjediset e klinikës, mjetet e punës, protezat, implantet, zbardhimin e dhëmbëve, higjienën e gojës etj. Gjithashtu u zhvillua një diskutim mbi sfidat e një mjeku stomatolog në ditët e sotme. Doktoresha u foli nxënësve për specializimet që mund të bëjë një stomatolog, pas përfundimit të fakultetit, si dhe për mundësitë e punësimit, pas studimeve.



Vizitë në Bashkinë e Tiranës

Klubi i Ekonomisë zhvilloi një vizitë frytdhënëse në Bashkinë e Tiranës. Nxënësit u informuan për çështje të rëndësishme në lidhje me organizimin e këtij institucioni. U jemi mirënjohës përfaqësuesve të Drejtorisë së Trajnimit dhe Zhvillimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Tiranë, që mundësuan këtë takim.



Takim me CEO-n e Intesa Sanpaolo Bank

Klubi i Ekonomisë zhvilloi një takim të hapur me përfaqësues e drejtues të departamenteve të ndryshme të bankës.

Pjesë e këtij takimi ishin z.Alessandro D'Oria, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania, znj. Entela Zigori, Drejtuese e Departamentit të Burimeve Njerëzore, z.Julian Çela, Drejtues i Përgjithshëm Financiar i Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe znj. Jola Dima, Drejtuese e Departamentit të Riskut në Intesa Sanpaolo Bank Albania. Nxënësit, të shoqëruar edhe nga Drejtori i shkollës, z. Mustafa Gezen, patën mundësi të drejtonin pyetje për sektorin bankar, ekonominë në vend dhe rajon, si dhe për prirjet financiare të së ardhmes.

Biseda mes nxënësve dhe përfaqësuesve të bankës ishte e gjallë, interaktive dhe interesante.



Takim me logopeden, Iva Muskaj

E ftuara e radhës nga Klubi i Mjekësisë ishte Iva Muskaj, Logopede dhe Specialiste e Metodës ABA.

Znj.Muskaj realizoi një seminar informues rreth fushës së Logopedisë, duke u ndalur te vështirësitë dhe sfidat e një logopedi në Shqipëri.

Gjithashtu, logopedia ndau me nxënësit përvoja rreth sfidave të të punuarit me fëmijë me problematika, si: sindroma Down, autizmi, vështirësitë në të nxënë, problematika në të folur, si dhe vështirësitë që hasin fëmijët në shoqërinë tonë.

Pjesë e bisedës ishte dhe rrugëtimi i një logopedi: fushat e specializimit, pritshmëritë për të ardhmen etj.





Trajnimi Skills 4 Change Albania

Nxënësit e Klubit Public Speaking dhe Critical Thinking and Creativity prej tri ditësh ishin pjesëmarrës në trajnimin Skills 4 Change Albania me partneritet gjerman, që synon të nxjerrë në pah dhe promovojë vlerat e individit, apo ato që ndryshe njihen si “aftësitë e buta”. Aftësitë e buta janë një kombinim i aftësive sociale e komunikuese, karakteristikave të personalitetit apo mënyrës se si duhet të sillemi në mënyrë që të arrijmë të bashkëpunojmë siç duhet në skuadër, në ambiente shoqërore apo të punës, për të arritur maksimalisht qëllimet që vetë individët i përcaktojnë.

Pikërisht këtë u përpoq të përcjellë tek nxënësit tanë, themeluesja e kësaj qendre, Erida Shkalla. Nëpërmjet ushtrimeve psikologjike, të cilat u zhvilluan në formën e lojërave, nxënësit arritën të përmirësojnë ndjeshëm komunikimin me njëri-tjetrin, frymën e bashkëpunimit, lidhshimin, si dhe menaxhimin e kohës, si një aset i vyer për këdo.



Seminar nga AMA

Klubet e Mjekësisë, zhvilluan një trajnim nga prof. dr. Gary Russell, mbi patologjitë dermatologjike.

Nxënësit u njohën me mënyrat e diagnostikimit të sëmundjeve të ndryshme të lëkurës.

Seminari ishte interaktiv dhe frytdhënës.

I jemi falenderues Albanian Medical Association, veçanërisht disa pjesëtarëve të stafit:

Gary Russell- mjek familje, pedagog në SHBA dhe në Universitetin e Mjekësisë

Aureta Bruçi- Gastrohepatologe/ pjesë e stafit të AMAs

Jonathan Pano -Pjesë e bordit drejtues/ Auditues financiar

Armida Çausi - Vullnetare/Pedagoge/ Inxhinierë e sigurisë kibernetike

Seminar nga Sonila Bitri, rreth Drograve dhe Varësive ndaj tyre

Seminari i radhës bëri bashkë Klubet e Mjekësisë.

Nxënësit tanë patën mundësi të zhvillonin një diskutim me mjeken toksikologe, Sonila Bitri, rreth drograve dhe varësisë ndaj tyre.

Nuk munguan mendimet dhe pyetjet e nxënësve, si edhe informacionet e rëndësishme nga znj. Bitri, ndërsa pati edhe diskutime mes nxënësve rreth kësaj teme me impakt të madh në shoqërinë e sotme.

Znj. Sonila Bitri e nisi seminarin me një historik rreth drograve. Më pas tregoi e dha më shumë informacione rreth rolit që luan mjeku për individët me varësi ndaj këtyre substancave.

Nxënësit ishin kuriozë rreth kësaj çështjeje, pra për rolin e mjekut dhe për ndikimin që ai ka në lënien e drograve, si: kanabisi, duhani dhe alkooli.

Gjithashtu, sipas studimeve, rezulton se moshë më e prekur nga varësia ndaj drograve, janë pikërisht adoleshentët, çka solli më tepër diskutim mes nxënësve. Njëri-tjetrin, frymën e bashkëpunimit, leadershipin, si dhe menaxhimin e kohës, si një aset i vyer për këdo.



Vizitë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social

Një nga çështjet më të rëndësishme të perspektivës globale, janë shërbimet sociale.

Nxitur nga kjo gjë, nxënësit e Global Perspectives Club dhe nxënësit e Klubit të Historisë vizituan sot Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, ku patën një bashkëbisedim me shumë interes me drejtorin e këtij institucioni, rreth ndihmës ekonomike, risive në fushën e shërbimeve sociale dhe rëndësisë së bashkëpunimit të grupeve të ndryshme shoqërore mbi shërbimet sociale.





Vizitë unike në ambientet e Spitali Amerikan 3

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë patën mundësinë e një vizite unike në ambientet e Spitali Amerikan 3.

Ata u njohën me pajisjet mjekësore të avancuara, duke shqyrtuar më nga afër teknologjinë dhe metodologjinë e përdorur në këtë mjedis shumë të rëndësishëm shëndetësor. Gjatë kësaj vizite, nxënësit zhvilluan një bisedë interesante dhe informuese me një kardiolog të spitalit. Kardiologu tregoi për rëndësinë e ekografisë së zemrës dhe shpjegoi procesin e interpretimit të një elektrokardiogrami, duke ndarë me ta përvojën e tij dhe mënyrën se si mjekësia e përdor teknologjinë për të diagnostikuar dhe trajtuar sëmundjet kardiovaskulare.

Ky përvojë e rëndësishme sigurisht që do të ndikojë në zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të nxënësve tanë në fushën e mjekësisë, duke i frymëzuar ata për të ndjekur rrugën e një arsimimi të vazhdueshëm dhe për të kontribuar në shëndetin dhe mirëqenien e shoqërisë në të ardhmen.



Seminar me temë: “Management of Information Systems”

Në shkollën tonë u zhvillua një seminar me temë : “Management of Information Systems”.

Nxënësit e Klubit të Programimit dhe Inxhinierise u informuan rreth profesioneve që mund të ushtrojnë nëse studiojnë në këtë degë. E ftuar në këtë seminar ishte pedagogia Ardita Dorti, nga Universiteti Epoka.

Nxënësit shfaqën interes të lartë për të marrë më tepër njohuri rreth kësaj fushe.



EKSURSIONE





Udhëtim në Mynih

Nxënësit tanë udhëtuan drejt Mynihut, duke krijuar kontakte të rëndësishme dhe të vlefshme. Ata vizituan Universitetin e Biznesit të Mynihut dhe patën mundësinë të takohen me ish-nxënësit tanë që janë diplomuar ose që i vazhdojnë studimet aty. Në këtë udhëtim, nxënësit morën një përvojë të dorës së parë, duke parë nga afër qytetin e universitetit, si dhe duke marrë njohuri nga ata që kanë qenë atje më parë.



Maturantët e shkollës sonë zhvilluan një udhëtim magjik në Romë.

Të vizitosh Romën do të thotë të përfshihesh nga ndjesi të mrekullueshme, të cilat t'i jep historia dhe bukuritë e këtij qyteti antik. Nxënësit vizituan pikat kryesore turistike, si: Koloseun, Forumin Romak, Monumentin e Viktor Emanuelit II dhe Fontana di Trevin. Kuzhina italiane autentike, restorantet e vogla e rrugicat e ngushta, krijuan kujtime të paharrueshme e ndjesi të pasura kulturore, që do të mbeten gjatë në memorie.



Nxënësit tanë vizitojnë Hungarinë


Nxënësit tanë, të klasës së 11-të, zhvilluan një udhëtim të paharrueshëm në Hungari, duke zbuluar atraksionet, muzetë, kështjellat, universitetet dhe duke marrë pjesë në aktivitetet argëtuese që ofron ky vend.





Udhëtim në Mynih

Dita e parë e udhëtimit në Mynih ishte e pabesueshme! Nxënësit tanë të klasave të 11-ta kaluan një kohë të mrekullueshme, duke vizituar Universitetin e Biznesit të Mynihut dhe duke eksploruar qendrën e qytetit. Mezi presim të shohim se çfarë na rezervon pjesa tjetër e udhëtimit, ndërsa vazhdojmë të vizitojmë universitetet e tjera në Mynih dhe të zbulojmë atraksione të tjera në të gjithë qytetin.



Vizitë në qytetin e Korçës

Vajzat e klasës së 11-H, zhvilluan një shëtitje të këndshme në qytetin e bukur të Korçës. Kjo shëtitje ishte e mbushur me informacione të reja për nxënëset tona, të cilat njohën dhe vlerësuan magjinë e vërtetë të artit dhe të kulturës që mbart ky qytet, në veçanti të Mësonjëtores së parë të gjuhës shqipe. Këto copëza përbëjnë identitetin tonë kombëtar, ndaj kultivimi i tyre meriton një vëmendje të veçantë.





Udhëtim në Gjermani

Grupi i nxënësve që vizituan Gjermaninë, në ditën e dytë të këtij udhëtimi, vizituan dy prej universiteteve më të mira në vend: TUM dhe LMU. Të dy këta universitete ndajnë vendin e parë në renditjen e Gjermanisë dhe janë ndër 50 universitetet më të mira në botë.

Nxënësit tanë patën mundësinë që të eksplorojnë kampuset e bukura, të hedhin një sy në Fakultetin e Mjekësisë, të kontrollojnë bibliotekat e klasat dhe të mësojnë rreth mundësive akademike dhe kërkimore që këto universitete ofrojnë.

Pjesë e kësaj guide u bënë ish-nxënësit tanë, të diplomuar aty, Jera, Ergi, Blerti dhe Rajan, që ishin udhërrëfyes të mrekullueshëm.

Ne jemi të emocionuar të shohim se ku do t'i çojë arsimimi i tyre cilësor!



Udhëtim në Holandë

Që në ditën e parë në Holandë, nxënësit tanë duket se po mësonin kaq shumë gjëra. Nxënësit e Klubit të Mjekësisë patën mundësinë të vizitojnë universitetet më të mira në Amsterdam, duke përfshirë Universitetin e Amsterdimit, Universitetin Vrije dhe Kolegjin Universitar të Amsterdimit. Ata bënë turne në çdo kampus dhe patën mundësi të marrin informacione drejtpërdrejtë nga ekipet e pranimit të këtyre universiteteve.





Udhëtim në Barcelonë

Klubi i Historisë dhe i National Geographics zhvilluan një udhëtim në Barcelonë, ku u njohën me historikun, arkitekturën dhe mjedisin natyror të këtij qyteti.

U vizitua Sagrada Familia, Parku "Guell", Akuariumi, Casa Batllo, La Pedrera etj.




Eksplorimi i jetës universitare në Milano!

Nxënësit tanë patën mundësi që gjatë udhëtimit të tyre në Itali të vizitojnë një nga universitetet më prestigjioze të këtij vendi, Universitetin Politeknik të Milanos. Ata eksploruan arkitekturën mahnitëse dhe klasat frymëzuese. Për ta, kjo ishte një përvojë shumë e rëndësishme.. gjallë holandeze.



Udhëtim në Oslo, Norvegji

Nxënësit tanë ndërmorën një udhëtim të paharrueshëm në Oslo, ku eksploruan të gjitha atraksionet ikonike të qytetit, nga Qendra e Çmimit Nobel dhe Muzeu Kombëtar, deri te Shtëpia e Operas dhe Muzeu Viking. Ata gjithashtu vizituan Kopshtin Botanik, lundruan nëpër fjarde mahnitëse dhe shijuan të gjithë kulturën që ofron ky qytet i mrekullueshëm. Një udhëtim zbulimi, mësimi dhe frymëzimi!



Udhëtim në Romë

Nxënësit e Klubit të Historisë udhëtuan drejt Romës, për të njohur më mirë historinë e këtij qyteti. Nga rrënojat e lashta të Koloseut deri te veprat mahnitëse të artit të Muzeve të Vatikanit, ata morën të gjitha pamjet dhe tingujt e këtij qyteti të jashtëzakonshëm, duke mbledhur shumë kujtime.



Vizitë në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta

Vizitën e parë, në zonat e mbrojtura, Klubi i National Geographics dhe Klubi i Historisë e zhvilluan në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, ku u njohën me florën dhe faunën e këtij parku.

Vizita në Muzeun e Zogjve, Kulla 360 gradë, shëtitja në pedonalen e parkut, si dhe mbjellja e një pishë ishin disa nga aktivitetet që klubet zhvilluan.





Grupi Top Scorers eksursion në Gjermani



Nxënëset e Grupit të Ekselencës vizituan Ludwig Maximilian University (LMU). Kjo përvojë ishte mjaft e veçantë dhe frytdhënëse, sepse vajzat mësuuan më shumë për jetën studentore në Mynih. Ish-nxënësit e shkollës sonë, që studiojnë në këtë universitet, me shumë kënaqësi u ofruan të prezantonin universitetin e tyre. Duke u konsultuar me ta, vajzat panë këtë universitet në një formë më të detajuar. Kjo i ndihmoi ato që të qartësojnë idetë e tyre për studimet e larta.



Vizitë në muzeun Bunkart

Klubet e Historisë dhe National Geographics vizituan muzeun Bunkart, ku u njohën me mënyrën se si regjimi komunist siguronte udhëheqjen e lartë të shtetit në rast të sulmeve nga jashtë, kontrollin e territorit, presionin ndaj disidentëve etj.

Udhëtim në Mynih



Nxënësit e Programit të Ekselencës, bënë një udhëtim të mrekullueshëm në Mynih, Gjermani. Qëllimi i këtij udhëtimi ishte të vizitoheshin universitetet më të mira në Gjermani. Ditën e parë të këtij udhëtimi, ata vizituan kampusin TUM. Ish-nxënësit tanë, që tani po studiojnë në TUM, i pritën krahëhapur dhe i treguan ambientet përreth. Ata ndanë përvojat e tyre dhe u dhanë një pasqyrë të jetës në këtë universitet.



Klubi i Arkitekturës viziton Vjenën

Nxënësit e Klubit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë zhvilluan një udhëtim frymëzues në Vjenë. Dita e parë e udhëtimit i përfshiu plotësisht, ndërsa ata u zhytën në historinë e pasur dhe bukuritë befasuese të atraksioneve kryesore të Vjenës dhe muzeve më të njohur.

Udhëtim në Zvicër

Klubi i Arkitekturës dhe Klubi i Inxhinierisë kaluan një kohë të mrekullueshme, duke eksploruar Zvicrën. Në ditën e parë të udhëtimit, nxënësit vizituan CERN-in, i cili ka famë botërore dhe arritën të vështronin pak nga prapaskenat e kërkimit të fundit që po ndodh atje. Të emocionuar për përvoja të tjera të pabesueshme që do rezervojë ky udhëtim, ata vazhduan të mësojnë, të rriten dhe të frymëzohen nga arkitektura e bukur dhe bëmat inxhinierike të këtij vendi mahnitës. Eksplorimi i historisë së pasur dhe përpjekjeve humanitare të Muzeut Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në Gjenevë, ishte një përvojë vërtet mahnitëse. Kryqi i Kuq daton që nga viti 1863 dhe vazhdon funksionin e misionin e tij edhe sot. Kjo i bëri nxënësit tanë që të fitojnë një vlerësim më të madh për rolin e rëndësishëm që ka luajtur dhe akoma luan Kryqi i Kuq në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për njerëz në nevojë.



Klubi i Mjekësisë viziton Gjermaninë

Një tjetër udhëtim i mrekullueshëm nga nxënësit e Klubit të Mjekësisë në Gjermani. Ky udhëtim ishte i organizuar për t'u ardhur në ndihmë nxënësve në lidhje me fushën e mjekësisë. Ata vizituan Fakultetin e Mjekësisë në LMU, Muzeun e Anatomisë, Kopshtin Botanik, Muzeun e Shkencës, Muzeun e Astronomisë, Kopshtin Zoologjik të Mynihut, Muzeun BMW, Pallatin Mbretëror të Nymphenburgut, Laboratorin Biotopia, Muzeun e Historisë Natyrore, Marienplatz, Muzeun e Bayern Mynihut dhe shumë më tepër. Në këtë mënyrë, nxënësit u argëtuan dhe pasuruan njohuritë e tyre në mjekësi.






Vizitë në Universitetin Webster

Grupi i nxënësve që ka udhëtuar për të eksploruar Zvicrën, pati një përvojë shumë të bukur ditën e fundit të këtij udhëtimi, duke vizituar Universitetin prestigjioz Webster!

Si një universitet partner me 100 vjet përvojë dhe 50 kampuse në mbarë botën, Webster është një lider global në arsimin e lartë. Nxënësit tanë ishin në gjendje të shikonin nga brenda objektet dhe programet akademike të klasit botëror të ofruara në Webster, madje patën mundësinë të takoheshin me pedagogë dhe studentë. Jemi mirënjohës për partneritetin mes institucioneve tona dhe presim bashkëpunim të vazhdueshëm në të ardhmen. Ky udhëtim ka qenë një përvojë e paharrueshme e mbushur me mësim, rritje dhe frymëzim.

Vizitë në Shpellën e Mermerit



Ekspeditat mësimore në vendet më të bukura dhe më të veçanta shqiptare, janë pjesë e programeve të klubeve, në shkollën tonë. Nxënësit tanë, në aktivitetin e radhës, vizituan Shpellën e Mermerit ose Shpellën e Gadimes, e cila është një shpellë gëlqerore karstike, në fshatin Gadime e Ulët, të komunës së Lipjanit, në Kosovë. Bukuritë e kristaleve dhe pamjet mahnitëse impresionuan nxënësit, të cilët u njohën nga afër me historikun dhe rëndësinë e saj.



